



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 10 gusht 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Veselit për Zgjatje të Afatit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në pajtim me nenin 41(10) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), dhe rregullat 9, 57(2) dhe 82(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 2 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Kadri Veselit (“z. Veseli”) (“Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin”).² Në atë vendim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu urdhëroi z. Veseli që të paraqesë, nëse dëshiron, parashtrime mbi rishikimin e ardhshëm të paraburgimit, ose deri të enjten, 12 gusht 2021, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të parashikuara në rregullën 76 të Rregullores, ose deri më 26 gusht 2021, në përgjigje të parashtrimeve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) që do të dorëzohen më 16 gusht 2021.³

2. Më 15 korrik 2021, z. Veseli parashtroi apel kundër Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin.⁴

3. Më 21 korrik 2021, gjatë konferencës së gjashtë mbi ecurinë e çështjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vërejti se disa nga të akuzuarit, ndër të cilët z. Veseli, kishin parashtruar apele kundër vendimeve për vazhdimin e paraburgimit. Ai më pas pyeti nëse të akuzuarit në këtë çështje synonin të kërkonin shtyrjen e rishikimit të ardhshëm të paraburgimit, apo preferonin që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të bënte

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F000380, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Kadri Veselit*, 2 korrik 2021, publik, para. 57(a).

³ Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 57(b) dhe (c).

⁴ KSC-BC-2020-06, IA008/F00001, Mbrojtja e z. Veseli, *Apel i Veselit kundër Vendimit KSC-BC-2020-06/F00380 (Rishikimi i Parë i Paraburgimit)*, 15 korrik 2021, konfidencial.

rishikimin e paraburgimit të tyre brenda dy muajsh nga rishikimi i fundit.⁵ Mbrojtja e z. Veseli deklaroi se nuk do të kërkonte shtyrje dhe i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake të “vazhdojë me detyrimin [e tij] për rishikimin e paraburgimit brenda afatit ligjor”.⁶

4. Më 9 gusht 2021, Mbrojtja e z. Veseli rivlerësoi qëndrimin e vet dhe kërkoi ndryshimin e afatit për dorëzimin e parashtrimeve në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit dhe zgjatjen e tij deri në dhjetë ditë nga marrja e vendimit të pritshëm të Panelit të Gjykatës së Apelit në lidhje me apelin e tij (“Kërkesa”).⁷ Z. Veseli gjithashtu bëri të ditur se gjatë periudhës së ndërkohshme, ai heq dorë nga e drejta për rishikimin e paraburgimit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁸

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të shkurtojë *proprio motu* afatet e përcaktuara në Rregullore, ose të përcaktuara nga Paneli.

6. Sipas rregullës 9(6) të Rregullores, kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtare, vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve mund të merret edhe pa i dhënë palës kundërshtare mundësinë për të shprehur mendimin.

7. Sipas rregullës 82(5) të Rregullores, një panel mund të ndryshojë statusin e një parashtrimit të protokolluar *proprio motu*, në qoftë se arsyet për një klasifikim të caktuar pushojnë së ekzistuari.

⁵ KSC-BC-2020-06, Transkript, 21 korrik 2021 (“Transkripti i 21 korrikut 2021”), publik, f. 532, rreshtat 10-18.

⁶ Transkripti i 21 korrikut 2021, f. 533, rreshtat 13-15.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00429, Mbrojtja e z. Veseli, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit Lidhur me Rishikimin e Dytë të Paraburgimit*, 9 korrik 2021, konfidenciale, para. 2-3.

⁸ Kërkesa, para. 2.

8. Neni 41(10) i Ligjit dhe rregulla 57(2) e Rregullores parashikojnë se pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Paneli i angazhuar me çështjen vlerëson nëse ekzistojnë ende arsytet për mbajtjen në paraburgim dhe jep një vendim për vazhdimin ose përfundimin e paraburgimit.

III. DISKUTIM

9. Duke marrë parasysh heqjen dorë të z. Veseli nga e drejta për rishikimin e paraburgimit brenda afatit ligjor, si edhe faktin se do të ishte më mirë që parashtrimet e z. Veseli mbi paraburgimin të bëhen pas shqyrtimit të vendimit të pritshëm të Panelit të Gjykatës së Apelit lidhur me apelin e tij kundër Vendimit të Dytë mbi Paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë paraqitur arsye të vlefshme që përlligjin zgjatjen e kërkuar të afatit.

10. Duke marrë parasysh se Mbrojtja nuk i ka deklaruar arsytet për klasifikimin konfidencial të Kërkesës së saj dhe duke konstatuar, pas një rishikimi të kujdesshëm, se Kërkesa nuk nxjerr ndonjë informacion konfidencial, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndryshon statusin e Kërkesës nga konfidenciale në publike, në pajtim me rregullën 82(5) të Rregullores.

IV. VENDIM

11. Për arsytet e sipërpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **MIRATON** Kërkesën dhe **URDHËRON** z. Veseli të dorëzojë parashtrime lidhur me nëse ekzistojnë ende arsytet për vazhdimin e paraburgimit, jo më vonë se **dhjetë ditë pas njoftimit të vendimit të pritshëm të Panelit të Gjykatës së Apelit** mbi apelin e tij kundër Vendimit të Dytë mbi

Paraburgimin, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores;

- (b) **URDHËRON** ZPS-në që, në rast se z. Veseli vendos të mos bëjë parashtrime brenda afateve të sipërpërmendura, të dorëzojë parashtrimet e veta lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Veseli jo më vonë e **dhjetë ditë pas afatit të z. Veseli**, dhe zotin Veseli që të dorëzojë parashtrimet e veta, nëse dëshiron, jo më vonë se dhjetë ditë pas afatit të ZPS-së; dhe
- (c) **URDHËRON** Administratoren të riklasifikojë Kërkesën (F00429) si publike.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E martë, 10 gusht 2021

Në Hagë, Holandë.